



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI BUJQËSOR I TIRANËS
DREJTORIA E BURIMEVE NJERËZORE DHE SHËRBIMEVE JURIDIKE

Nr. 3304/1 Prot.

Tiranë, më 27/10/2025

OFERTE – PUNE

Universiteti Bujqësor i Tiranës shpall 1 (një) vend pune për personel ndihmës akademik me karakter administrativ në kategorinë “Laborant” pranë Departamentit të Industrisë së Drurit, Fakulteti i Shkencave Pyjore.

Laborant, klasa e VI me vështirësi në punë në shkallët I+II+III

Kritere të Veçanta:

- Të jetë me arsim të mesëm;
- Të ketë eksperiencë pune të profilizuara në përpunim druri, zdrukhtari montime, instalime, mirëmbajtje dhe riparime;
- Të ketë aftësi teknike të certifikuara në Zdrukhtari-Punime Druri; Pylltari dhe Mbrojtje të Pyjeve;
- Të ketë aftësi për të punuar si në mënyrë të pavarur ashtu dhe në ekip duke ndërtuar një raport të drejtë dhe korrekt me kolegët dhe studentët.
- Të jetë kompetent, i ndërgjegjshëm dhe i motivuar me një qasje metodologjike pune, i adaptueshëm dhe fleksibël me cilësitë për të mësuar praktika të reja.
- Të jetë fleksibël me oraret e punës në varësi të ngarkesës së punës;

Në rast mosplotësimi të kriterëve më sipër dosja e aplikantit nuk pranohet.

Konkursi do të zhvillohet në godinën A të Fakultetit të Ekonomisë dhe Agrobiznesit (kati I), Zyra 125 **në datën 04.11.2025, ora 13:00.**

Të interesuarit do të dërgojnë **dokumentacionin e nevojshëm** në Drejtorinë e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Juridike të Universitetit Bujqësor të Tiranës jo më vonë se **data 03.11.2025.**

Kriteret e përgjithshme dhe dokumentacioni i nevojshëm janë të bashkëngjitura.

ADMINISTRATORI
Edmond TËRTHORJA

NË MUNGËSË DHE ME VËNDIM
ADMINISTRATORI NJËSISË KRYESORE
Valbona SHEHU

